



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Korrik 2022

Nr: 186

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS**  
**“QENDRESA QYTETARE” NDAJ Z. FATMIR JUKA, PËRGJEGJËS I GALERISË SË**  
**ARTEVE SHKODËR DHE Z. XHEMAL BUSHATI, KANDIDAT PËR KRYETAR I**  
**BASHKISË SHKODËR, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË**  
**FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR**  
**BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 22 Korrik 2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në séance dëgjimore denoncimin që i përket:

**Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”

**Objekt:** Takim elektoral në ambientet e Galerisë së Arteve Shkodër, në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor.

**Ndaj:** Z. Xhemal Bushati, Kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër  
Z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, neni 21, shkronja “dh” dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencie



Data 22 Korrik 2022

Nr. 186

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare,” ndaj z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”

dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## VËREN:

### I. Vlerësimi paraprak

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 05.03.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së, është raportuar denoncimi me nr. 3691 ID, nga Organizata “Qendresa Qytetare” për shkelje të pikës 3, të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe në shkronjën “d”, nën-pika 1.3, pika 1, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në denoncimin e Organizatës “Qendresa Qytetare” pretendohet se: “Në datën 23.02.2022 Kandidati i Partisë Demokratike të Shqipërisë, për kryetar i Bashkisë Shkodër, z. Xhemal Bushati, ka vizituar Galerinë e Arteve Shkodër dhe është pritur nga drejtori i këtij Institucioni. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, pika 2 datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator; për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur nenin 91, pasi nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve, burime (asetet) të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor; në aktivitete me karakter politik, në referim edhe të nenit 3, pika 1.1/c të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Gjithashtu, në referim të nenit 6, pika 3, “Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore



*i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.*

*Në këtë rast, Fatmir Juka, sikurse shihet nga pamjet, është pjesëmarrës në një veprimtari me karakter politik, fakt për këtë është ligjërata dhe premtimet e dhëna nga kandidati z. Bushati.*

*Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të kandidatit, por edhe nga publikimi në media, ai shprehet se: “Unë e kam një projekt për ta zbatuar, që kurrë nuk gjeti vullnetin e të tjerëve. Në fakt e kam kërkuar që kur isha kryetar i këshillit bashkiak. Ta kthejmë ndërtesën në të cilën sot ndodhet Këshilli i Qarkut Shkodër, në një muze, në një shtëpi më shumë për artin. Bashkë, ta kthejmë Shkodrën aty ku i takon, në pedestalin e identitetit!”.*

*Ndër të tjera, në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ky takim, nuk rezultoi të jetë raportuar sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.*

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike nga takimi në Galerinë e Arteve Shkodër si dhe provat në link.

Provat: Link:

- <https://www.facebook.com/xhemalbushati/posts/121433020453324>

- <https://youtu.be/FAktOTBqy3k>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
  - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
  - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
  - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të

organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

5. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi “Qendresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj të denoncuarve z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër dhe z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër.
6. Në lidhje me të denoncuarin subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se: duke ju referuar vendimit nr. 19, datë 31. 05.2022 të KAS-it, ku thuhet se *“Në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi Zgjedhor si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfutues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”*, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ, pavarësisht se ka qenë subjekt i denoncimit, për arsyen e sipërpërmendur, nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.

## II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator mbi *“Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*.  
Në denoncimin e mësipërm pretendohet se, është kryer një takim që bie në kundërshtim me nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1583 prot., datë 05.03.2022, ka kërkuar informacion të detajuar nga z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, në lidhje me denoncimin e bërë nga Organizata “Qëndresa Qytetare” për organizimin e këtij aktiviteti.

9. Me shkresën nr. 3 prot., datë 09.03.2022, administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1714 prot., datë 11.03.2022, z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, ka sqaruar se: *“Në datën e sipërcituar 23.02.2022 është paraqitur z. Xhemal Bushati, pranë ambienteve të Galerisë së Arteve Shkodër, pa një njoftim zyrtar të dokumentuar me shkresë, brenda orarit zyrtar të punës, çka ka bërë që nga ana ime si funksionar i një institucioni publik ta konsideroj, prezencën e tij në cilësinë e qytetarit të zakonshëm dhe jo në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie, duke mos shprehur në asnjë moment gatishmëri për mbështetje politike, por vetëm në funksion të detyrës sime, pritje, sqarim, përcjellje dhe momenti kur z. Bushati prononcohet me premtimet e veta, nuk kanë aspak lidhje me atë çka unë shprehem.*
10. Palët e tjera në këtë denoncim nuk paraqitën asnjë pretendim.
11. Në deklaratën e publikuar z. Bushati citon: *“Unë e kam një projekt, ndërtesën e Këshillit të Qarkut ta kthej në një muze arti. Ky projekt ka filluar që në kohën kur unë isha kryetar i Këshillit. Ajo është një pronë e Bashkisë, i është dhënë me qira Këshillit të Qarkut. Do të mendojmë të gjithë bashkë për sistemimin e Këshillit të Qarkut në një ndërtesë shumë komode. Ju kërkoni që Bashkia Shkodër të ndihmojë Galeritë. Unë premtoj që gjithë këto kërkesa që ju keni, do të kenë mbështetjen time. Do të futet në axhendën e turizmit të Shkodrës. Galeria dhe muzeu i arteve e kanë vendin aty ku u takon. Kjo do të jetë, pra do të vazhdojë me qenë në mbështetje. Bisedojmë, projektojmë së bashku. Kjo kërkesë është kërkesë e hershme e artistëve të Shkodrës”.*
12. Në deklaratën e dhënë nga përgjegjësi i Galerisë së Arteve, z. Juka citohet: *“Kushtet e Galerisë së Arteve Shkodër, kanë ardhur vit pas viti duke i’u afruar standardit, deri diku një standard optimal për ekspozim. Si hapësirë ekspozuese e themi pa frikë se Galeria e Arteve Shkodër, është një nga pesë Galeritë më të mëdha në Shqipëri. Ka dhe një fond relativisht të mirë, ku prek disa periudha historike, që nga Rilindja Kombëtare, Lufta e dytë Botërore, Realizmi Socialist, që ndërpritet në vitet 1990 pasi ka disa risi të tjera që e pasurojnë me rrethana të tjera artistike dhe në këndvështrime të tjera dhe me një analizë tjetër, në ecje me zhvillimet shoqërore”.*
13. Kjo vizitë është pasqyruar në profilin e kandidatit për kryetar Bashkie në rrjetin social “Facebook” dhe një televizion lokal, e cila ka publikuar një video në “Youtube”.
14. Me vendimin nr. 157, datë 05.05.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe Partia Demokratike për shkelje të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sepse hetimi administrativ rezultonte ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

15. Në vijim të hetimit administrativ, palëve në proces u është dërguar shkresa nr. 2384 prot., datë 13.05.2022, “Njohje mbi gjetjet e denoncimit”, më konkretisht subjekteve: z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 06.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Subjektet janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.
16. Brenda afatit të përcaktuar në shkresë, Organizata “Qendresa Qytetare”, ka paraqitur prapësimet e saj, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2460 prot., datë 23.05.2022, lidhur me pretendimet e paraqitura nga palët e denoncuara në vijim të përgjigjeve të tyre. Organizata “Qendresa Qytetare” përveç pretendimeve të paraqitura në denoncim, ka shtuar se:
- Shkelja është kryer gjatë orarit zyrtar;
  - Shkelja është në kundërshtim me vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, si dhe nenin 142 të Kodit Civil;
  - Z. Fatmir Juka, në momentin e marrjes dijeni që z. Xhemal Bushati do të kryente një dalje publike në media, për qëllime elektorale, kishte detyrimin ta ndalonte aktivitetin dhe të mos e shoqëronte kandidatin në daljen e tij publike;
  - Shkelja është kryer në ndalim të nenit 6, pika 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, fakt ky i provuar nga deklarata dhe premtimet e kryera nga z. Xhemal Bushati;
  - Deklaratat e kryera nga z. Xhemal Bushati shfaqin haptazi karakterin politik dhe elektoral të vizitës së kryer prej tij në Galerinë e Arteve;
  - Përveç të tjerave, nuk është kryer raportimi në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, aktiviteti në fjalë nga ana e z. Fatmir Juka, në kundërshtim me nenin 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator;
  - Nuk është paraqitur asnjë provë e ligjshme, e cila të vërtetojë se në këtë takim nuk janë përdorur burime të organeve apo enteve publike dhe palët e denoncuara nuk janë në shkelje të legjislacionit në fuqi, të sipërpërmendur.

Palët e tjera në këtë çështje nuk kanë paraqitur asnjë pretendim në lidhje me shkeljen e pretenduar.

17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2548 prot., datë 01.06.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët shkresërisht për zhvillimin e seancës degjimore. Për shkak të ndryshimeve të agjendës së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe afateve të ngushta për zhvillimin e kësaj

seance, palët janë njoftuar në mënyrë elektronike në email-in e tyre zyrtar për zhvillimin e kësaj seance në datën 31.05.2022. Seanca është kryer më 01 Qershor 2022 ora 10:00 me palë: Organizata “Qendresa Qytetare”, kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër, z. Xhemal Bushati, Përgjegjësi i Galerisë së Arteve Shkodër dhe z. Fatmir Juka dhe subjektit zgjedhor “Partia Demokratike.

18. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, dhe z. Rigels Xhemollari, autorizuar nëpërmjet autorizimit të nr. 2461 prot., datë 23.05.2022, datës 01.04.2022 dhe z. Marash Logu për të përfaqësuar kandidatin për kryetar të bashkisë Shkodër dhe subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”.
19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësuesit të organizatës “Qendresa Qytetare” dhe palëve të tjera në këtë proces, z. Marash Logu.
20. Për sa më sipër, përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, kërkoi të konstatohet shkelja dhe të merren sanksione administrative ndaj z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe Partia Demokratike. Në prapësimet e tyre, i qendruan denoncimit të kryer dhe pretendimeve të paraqitura më parë.
21. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi përfaqësuesit të z. Xhemal Bushati, njëkohësisht dhe Partisë Demokratike, z. Marash Logu, të parashtrijë pretendimet e tij në lidhje me denoncimin. Z. Logu citoi se denoncuesit gabohen në interpretimin e ligjit. Z. Bushati, sipas tij, është një person publik shumë i njohur dhe në këtë kontekst ka njohje të gjithanshme në Shkodër, përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e institucioneve publike, siç është rasti i z. Juka. Galeria e Arteve Shkodër, varet nga Ministria e Kulturës dhe do ishte e pamundur që një drejtor që varet direkt nga Ministria e Kulturës, të vihet në funksion të një kandidati për kryetar bashkie të Partisë Demokratike. Nga pikëpamja institucionale, z. Bushati nuk ka patur asnjë lloj mbështetje politike nga z. Juka apo person tjetër. Galeria e Arteve është një institucion me sipërfaqe të vogël dhe gjatë vizitës aty ndodh që të takojmë dhe përgjegjesin e galerisë. Pra, përgjegjësi i galerisë nuk ka patur asnjë lloj qëllimi që të vëjë në dispozicion institucionin që ai drejton apo veten, në funksion të kandidatit për Kryetar Bashkie. Ai është vënë në rolin e titullarit që e ka pritur, shoqëruar dhe përcjellë z. Bushati. Për më tepër, nga ana e z. Juka nuk ka asnjë fjalë që ta vendosë në pozita detyruese ose shkelje ligjore. Deklarata e z. Bushati i referohet një projekti të Galerisë së Arteve, me gjuhë të zhveshur nga qëllimi politik. Gjatë takimit në galeri nuk ka patur prezent njerëz të interesuar për fushatë elektorale. Gjithashtu nuk ka shkelje as nga z. Juka dhe është mirë që kur bëhet një denoncim, të parashikohet edhe shkelja ligjore apo dispozita ku bazohet. Në rastin konkret, z. Juka, z. Bushati dhe Partia Demokratike nuk kanë kryer asnjë shkelje. Fakti që

ka postuar foto në Facebook, është konsideruar si shkelje nga denoncuesit. Galeria e Arteve është ambient i mbyllur ku nuk mund të shkohet për fushatë, vërtetuar kjo dhe nga deklaratat, të cilat nuk kanë patur natyrë zgjedhore. Pavarësisht se vizita në Galerinë e Arteve ka qenë në kohë fushate, asnjëherë si është kërkuar z. Juka të vihet në funksion të z. Bushati dhe për këtë arsye z. Juka nuk është njoftuar për zhvillim të takimit, ai është pritur, shoqëruar, përcjellë si qytetar i thjeshtë.

22. Organizata “Qendresa Qytetare” në vijim të prapësimeve të tyre, deklaroi se nuk dilte e qartë pse Galeria e Arteve bënte përjashtim nga parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Nga ana e të denoncuarit u pretendua gjithashtu se z. Juka e ka pritur si qytetar, por në periudhë zgjedhore drejtuesit duhet të distancohen nga fushata. Z. Juka nuk duhet të lejojë përdorimin e ambienteve të punës dhe funksionin që ai mbart, ndërsa z. Bushati nuk duhej të përdorte burimet publike të këtij institucioni. Deklaratat e z. Bushati në lidhje me një projekt që ka për Galerinë dhe kthimin në identitet provon shkeljen e ligjit.
23. Pala e paditur në këtë proces, përfaqësuar nga z. Marash Logu, kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për t’u njohur me provat e administruara nga denoncuesi.
24. Në seancën e datës 28.06.2022 u bë shtyrja e seancës me kërkesë të përfaqësuesit të z. Bushati dhe Partisë Demokratike, z. Marash Logu.
25. Në seancën e datës 30.06.2022 u paraqitën në seancë z. Marash Logu dhe përfaqësuesit e Organizatës “Qendresa Qytetare” zj. Teisa Kurti dhe z. Rigels Xhemollari.
26. Z. Logu dorëzoi në seancë prokurën e posacme për përfaqësimin e z. Bushati, me nr. 1304 rep, nr.1659 kol datë 01.06.2022, dhe më pas vijoi me parashtrimin e pretendimeve e tij në lidhje me shkeljen e pretenduar nga denoncuesi.
27. Z. Logu citoi se provat e marra në administrim nuk janë në formën e kërkuar nga ligji dhe si të tilla nuk duhen të merren në cilësinë e provës materiale për të provuar shkeljen e pretenduar. Ai deklaroi se, provat janë thjesht disa foto të marra nga rrjetet sociale, janë lidhje link dhe një video e marrë nga Youtube, nuk janë as origjinale, as kopje të noterizuara. Barrën e provës në këtë hetim e ka denoncuesi dhe ai ka detyrimin e paraqitjes së tyre në formën e kërkuar nga ligji.
28. Organizata “Qendresa Qytetare” pretendoi se, qellimi i portalit të denoncimeve është që tu japë të gjithëve mundësinë e denoncimit të shkeljeve të konstatuara dhe jo të gjithë qytetarët janë në dijeni të procedurës ligjore apo formës së paraqitjes së provave.
29. Pretendimi i z. Logu u rrëzua nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi në gjykimin e tij, nga pikëpamja formale, bazuar në Kodin e Procedurës Administrative, ato përbëjnë provë, në kuadër të këtij hetimi administrativ. Provueshmëria e pretendimit është çështje tjetër, që shqyrtohet gjatë hetimit administrativ.
30. Z. Logu, vijoi më tej me prapësime të tjera. Sipas tij, denoncuesit pretendojnë se z. Juka ka vënë në mbështetje të z. Bushati një aset publik, bazuar në përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pa



kuptuar se çfarë nënkupton Kodi Zgjedhor me këtë parashikim. Z. Juka nëpërmjet shkresës vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka sqaruar se, z. Bushati e ka pritur/përcjellë në cilësinë e qytetarit të thjeshtë në ambjentet e këtij institucioni. Nëqoftëse z. Bushati do e kishte njoftuar më parë atëherë do të përbënte shkelje. Së dyti, pjesëmarrja e z. Juka në një veprimtari politike është e ndaluar. Një veprimtari e planifikuar/ njoftuar nga ana e z. Bushati do të konsiderohej me karakter politik. Z. Juka e ka sqaruar që nuk ka qënë e tillë, por një vizitë e thjeshtë, si qytetar, jo si mbështetës i kandidatit të Partisë Demokratike. Ai nuk është angazhuar as me mesazhe, as në fjalim politik. Ai është emëruar nga Partia Socialiste, nuk ka si të mbështesi Partinë kundërshtare në zgjedhje.

Së treti, në lidhje me mosraportimin e kësaj veprimtarie z. Logu deklaroi se veprimtaria nuk është e planifikuar, nuk ka karakter publik, mund të ketë patur qytetarë prezentë që janë duke vizituar Galerinë e Arteve, por është e paplanifikuar, kështu që nuk mund të raportohej si veprimtari.

Pra, nuk ka asnjë nga elementët e mësipërm për tu konsideruar shkelje ligjore.

Nga ana e Organizatës “Qendresa Qytetare”, është kërkuar vendosja e sanksioneve bazuar në përcaktimet e nenit 172, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020. Pika 1, e nenit 172, përcakton se *“subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”*. Kushti që duhet të vërtetohet nga hetimi është që veprimtaria të jetë kryer në favor të subjektit zgjedhor d.m.th. subjekti zgjedhor të ketë siguruar përfitim elektoral nga shkelja dhe që ky i fundit të mos ketë marrë masa për ndërprerjen e shkeljes, pas marrjes dijani. Që Partia Demokratike të konsiderohet me shkelje në favor të saj duhet të ketë marrë dijani dhe mos të ketë marr asnjë masë për ndalimin e kësaj shkelje. Në përfundim të deklarimeve të tij z. Logu, pretendoi se z. Bushati nuk është subjekt zgjedhor por është i propozuar nga Partia Demokratike, si kandidat i saj.

31. Organizata “Qendresa Qytetare” citoi se gjenden para një veprimtarie publike, pasi ka prezencë të Medias. Veprimtaria është e ndaluar pasi kandidati ka shpalosur platformën e tij, promovimin e një projekti të ardhshëm, ka përdorur një aset publik për këtë veprimtari. Z. Juka duhej të distancohej automatikisht nga ky aktivitet. Nuk mundej që kandidati, drejtuesi i Institucionit dhe media të bëhen bashkë dhe askush mos të ndalojë këtë veprimtari.

32. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike dhe kandidatit të saj, z. Xhemal Bushati, z. Marash Logu ka kërkuar 5 (ditë) ditë kohë për të paraqitur pretendimet e tij përfundimtare në lidhje me çshtjen objekt denoncimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të shtyjë seancën për ti dhënë mundësi z. Marash Logu të paraqesë pretendimet e tij. Brenda afatit 5 (pesë) ditë z. Logu nuk i paraqiti me shkrim pretendimet e tij përfundimtare të adresë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përfundoi hetimin administrativ.

33. Nëpërmjet shkresës nr. 2951 prot., datë 20.07.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njoftoi palët në proces për shpalljen e vendimit në datë 22.07.2022. Gjatë seancës së datës 22.07.2022, përfaqësuesi i z. Xhemal Bushati njëkohësisht dhe përfaqësues i subjektit zgjedhor Partia Demokratike, kërkoi ti jepej e drejta e fjalës për të dhënë pretendimet e tij përfundimtare sipas, kërkesës së bërë në seancën e datës 30.06.2022. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i'a dha të drejtën e fjalës për dhënien e pretendimeve përfundimtare.

Z. Logu deklaroi se z. Bushati nuk ka kryer fushatë elektorale në ambjentet e Galerisë së Arteve SHkodër dhe nuk ka pasur të ndëshkohet administrativisht sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor apo Vendimit nr. 09 datë 24.12.2020.

### III. Analiza ligjore

34. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në Galerinë e Arteve nuk përbën një veprimtari me karakter të hapur për publikun ose pjesëmarrjen e tyre.

35. Nuk rezultojnë e provuar që kryerja e kësaj vizite të ketë pasur si qëllim informimin e publikut apo ketë pasur pjesëmarrje të publikut.

36. Faktet e mësipërme provojnë se veprimtarisë së denoncuar i ka munguar karakteri publik që kërkon shkronja “a” e pikës 1.3 të nenit 3 të Vendimit nr .9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Karakteri publik është kushti për kategorizimin e llojit të veprimtarisë.

37. Vizita e kryer nga z. Bushati pranë Galerisë së Arteve, nuk është një veprimtari me karakter elektorale, pasi kjo vizitë në ambjentet e këtij Institucioni, ka qenë e pa njoftuar paraprakisht, nuk ka patur asnjë organizim nga palët si dhe nuk ka pasur vendosje të materialeve propagandistike për kryerje të fushatës elektorale.

38. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, aktiviteti i kryer nga kandidati për Kryetar Bashkie Shkodër, z. Bushati pranë Galerisë së Arteve Shkodër, në prani të përgjegjës të këtij Institucioni z. Fatmir Juka, nuk përfshihet në parashikimet e nenit 91, pika 1 dhe pika 2, të Kodit Zgjedhor. Sikurse është cituar edhe më sipër, nuk provohet që z. Juka të ketë vendosur ambjentet e këtij institucioni në dispozicion të kandidati për kryerjen e një aktiviteti elektorale.

39. Neni 6, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator parashikon se: *“Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor*

*ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.*

Pavarësisht faktit të pretenduar nga z. Juka se prezenca e tij, ka qenë në kuadër të përmbushjes të detyrave të tij funksionale si përgjegjës i këtij institucioni, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, z. Juka në zgjedhjet e ardhshme duhet të tregojë kujdes të shtuar për të mos përdorur institucionin publik për qëllime elektorale.

40. Për sa më sipër, nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se vizita e kryer nga kandidati për Kryetar Bashkie Shkodër, z. Xhemal Bushati, pranë Galerisë së Arteve Shkodër, në prani të z. Juka, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 21 shkronja “dh”, neni 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Xhemal Bushati, kandidat për Kryetar i Bashkisë Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”.
2. Pushimin e shqyrtimit administrativ për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”.
3. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator nga ana e z. Xhemal Bushati, kandidat për Kryetar i Bashkisë Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” dhe z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**



Data: 22 Korrik 2022  
Nr. 186

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare,” ndaj z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”